



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
BORDI I EDUKIMIT TË VAZHUESHËM

Nr. 89 Prot.

Tiranë, më 19.02.2016

VENDIM

Nr. 01 datë 19.02.2016

Për:

**EKSPERTËT E PAVARUR TË PROCESIT TË AKREDITIMIT TË AKTIVITETEVE
TË EDUKIMIT NË VAZHDIM PËR PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 33 “Edukimi i Vazhdueshëm Profesional”, të ligjit “Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, nr.10107, datë 30.03.2009, Bordi i Edukimit të Vazhdueshëm

VENDOSI:

1. Ekspertë të pavarur, të cilët do të përfshihen në vlerësimin e jashtëm të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë mund të jenë:
 - a. pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit të Mjekësisë, si dhe të institucioneve jopublike të arsimit të lartë të akredituara dhe licencuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit institucionalisht dhe për programin përkatës të studimit ku ata ushtrojnë aktivitetin, sipas fushës përkatëse të ekspertizës.
 - b. mjekët, farmacistët, stomatologët që kanë mbi 10 vite eksperiencë në fushën për të cilën kërkohet ekspertiza dhe kanë fituar gradën shkencore “Doktor”. Ata që kanë përfunduar studimet jashtë vendit duhet të jenë të pajisur me vërtetimin përkatës të njësimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;

- c. infermierët, mamitë, logopedët, fizioterapistët, imazheristët, që kanë mbi 10 vite eksperiencë në fushën për të cilën kërkohet ekspertiza, si dhe që janë të pajisur me diplomën “Master i Shkencave” të vlefshme në të njëjtën fushë të ekspertizës për vlerësimin e aktiviteteve të edukimit në vazhdim. Ata që kanë përfunduar studimet jashtë vendit duhet të jenë të pajisur me vërtetimin përkatës të njësimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
2. Të gjithë ekspertët duhet të jenë të licencuar për ushtrimin e profesionit përkatës brenda ose jashtë vendit.
3. Ngarkohet QKEV për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

MINISTRI
ILIR BEQAJ

